



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 52 prot.

Kamëz, më 25.6.2025

V E N D I M

Nr. 45 .Datë 25/6 2025

MBI

“KRIJIMIN E NDËRMARRJES SË PARQEVE DHE REKREACIONIT, KAMËZ”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 25.06.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.40 Datë 20.06.2025 në mbështetje të nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 23, pika 9, nenit 33, pika 1, nenit 54, shkronja “k” dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar: Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 119, datë 19.12.2024 “Mbi miratimin e detajimit të buxhetit për vitet 2025, 2026, 2027”, **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin e krijimit të Ndërmarrjes së Parqeve e Rekreacionit, Kamëz si institucion i veçantë në varësi të Bashkisë Kamëz.
2. Detyrat dhe funksionet e Ndërmarrjes së Parqeve e Rekreacionit, Kamëz do të jenë sipas përcaktimeve të bëra në aneksin bashkëlidhur këtij projekt-vendimi.
3. Numri i punonjësve të Ndërmarrjes së Parqeve e Rekreacionit, Kamëz do të jetë 75 (shtatëdhjetë e pesë).
4. Efektet financiare të këtij vendimi do të miratohen nga Buxheti i Bashkisë Kamëz, sipas zërit Gr.0, Kap. 5, Prog. 06260.
5. Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve sipas tabelës bashkëlidhur.
6. Për krijimin e strukturës së Ndërmarrjes së Parqeve dhe Rekreacionit, Kamëz ngarkohet Kryetari i Bashkisë Kamëz.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore si dhe Ndërmarrja e Gjelbërimit, Parqeve e Rekreacionit.
8. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë**.

KRYETAR KËSHILLI
HYSEN KOLDASHI

